

VENDIM
Nr. 764, datë 12.11.2014

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË SHËRBIMEVE NË QENDRAT SPITALORE UNIVERSITARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimi në qendrat spitalore universitare realizon funksione diagnostikuese e trajtuese themelore, në nivel të lartë shkencor, si pjesë e spitalit universitar, si dhe funksione mësimore e kërkimore, si pjesë e institucionit të arsimit të lartë.
2. Bordi i qendrës spitalore universitare përcakton numrin e përgjithshëm të shërbimeve dhe llojin e shërbimeve unike të qendrës spitalore universitare.
3. Shërbimi në qendrat spitalore universitare ka në përbërje të tij, të paktën, dy anëtarë efektivë si personel akademik për secilin specialitet, njëri prej të cilëve duhet të jetë, të paktën, me gradë shkencore “Doktor”.
4. Specialitetet me regjim të zakonshëm duhet të kenë shfrytëzim shtrati jo më pak se 85%, ndërsa specialitetet me regjim ditor duhet të kenë xhiro shtrati jo më pak se 85%. Shërbimi detyrohet, që, brenda katër viteve nga miratimi i këtij vendimi, të përmbushë këta tregues. Bordi miraton treguesit specifikë të organizimit të çdo shërbimi në qendrat spitalore universitare.
5. Numri i personelit mjekësor, që shërben në specialitetet e shërbimeve të ndryshme në qendrat spitalore universitare, miratohet çdo vit nga bordi i qendrës spitalore universitare.
6. Vendimi nr. 771, datë 7.11.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve për përcaktimin e numrit të personelit dhe kapaciteteve të njësisë së shërbimit në qendrat spitalore universitare”, shfuqizohet.
7. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama